



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË  
KANDIDATËVE TË PAVARUR PËR ANËTAR KËSHILLI BASHKIA HIMARË, ZNJ. SILVA  
JORGJI BURBO DHE Z. VASILLAQ HARILLA BOLLANO NË ZBATIM TË LIGJIT NR.  
138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,  
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të pavarur për anëtar këshilli Bashkia Himarë, zj. Silva Jorgji Burbo dhe Z. Vasillaq Harilla Bollano në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



**Nr . 594 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të pavarur për anëtar këshilli Bashkia Himarë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", zj. Silva Jorgji Burbo dhe z. Vasillaq Harilla Bollano kanë depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e tyre si kandidatë të pavarur për anëtar këshilli të bashkisë Himarë.

Gjithashtu zj. Silva Jorgji Burbo dhe z. Vasillaq Harilla Bollano në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se zj. Silva Jorgji Burbo dhe z. Vasillaq Harilla Bollano nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se zj. Silva Jorgji Burbo dhe z. Vasillaq Harilla Bollano janë të padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit 138/2015. Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, gërma f të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatëve për anëtar këshilli Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



**Nr . 594 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të pavarur për anëtar këshilli Bashkia Himarë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, gërma "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## **VENDOSI:**

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 86 për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e kandidatëve të pavarur për anëtarë këshilli Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, zj. Silva Jorgji Burbo dhe z. Vasillaq Harilla Bollano të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr . 594 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të pavarur për anëtar këshilli Bashkia Himarë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".